



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONI RREGULLATOR

Data: 20 Prill 2021

Nr: 20

VENDIM

**PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT TË PUNËS TË KOMISIONIT TË ZONËS SË
ADMINISTRIMIT TË ZGJEDHJEVE DHE GRUPIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE
PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E SHQIPËRISË, TË DATËS 25 PRILL 2021**

Në mbështetje të nenit nenin 20, pika 1, shkronja "gj", të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, Komisioni Rregullator pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V E N D O S I:

1. Të miratojë "Udhëzuesin e punës për Komisionin e Zonës së Administrimit të Zgjedhjeve dhe Grupin e Numërimit të Votave", në ndihmë të anëtarëve të KZAZ-ve dhe GN-ve, për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë, të datës 25 prill 2021, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Ilirjana NANO Kryetare

Arens ÇELA Anëtar

Dritan ÇAKA Anëtar

Helga VUKAJ Anëtar

Muharrem ÇAKAJ Anëtar

